

1. INFORMACION MBI RAPORTIN E MJAFTUESHMERISE SE KAPITALIT

Banka e monitoron përshtatshmërinë e kapitalit, përveç masave të tjera, nëpërmjet përdorimit të rregulloreve dhe raporteve të vendosura nga Rregullatori Shqiptar, Banka e Shqipërisë (“BSH”) e cila përcakton kapitalin rregullator të kërkuar për të mbështetur biznesin. Rregulloret e reja “Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit” dhe “Për kapitalin rregullator” të hyra në fuqi në vitin 2015 janë mbështetur në ligjin Nr. 8269, datë 23.12.1997 “Mbi Bankën e Shqipërisë” dhe Ligjin Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është raporti i kapitalit rregullator me ekspozimet e ponderuara me rrezikun, llogaritur si totali i vlerave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, si ato në bilanc edhe ato jashtë bilancit, për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, si dhe kërkesat për kapital për rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional.

Minimumi i përqindjes së kapitalit rregullator ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezik që kërkohet nga Banka e Shqipërisë është 12%. Minimumi i treguesit për kapitalin e nivelit të parë është 9% dhe minimumi i treguesit për kapitalin bazë të nivelit të parë është 6.75%.

Në dhjetor 2024, BKT ka raportuar përqindjet e mëposhtme:

- Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit 18.75% (dhjetor 2023: 17.60%);
- Raporti i kapitalit të nivelit të parë 17.93% (dhjetor 2023: 16.52%);
- Raporti i kapitalit bazë të nivelit të parë 17.93% (dhjetor 2023: 16.52%).

Mbështetur në rregulloren e Bankës së Shqipërisë nr. 4/2017 “Mbi mbikqyrjen e konsoliduar” Banka duhet të monitorojë normën e mjaftueshmërisë së kapitalit në baza individuale. Të njëjtët tregues rregullatorë minimalë zbatohen si më lart.

Në dhjetor 2024, BKT ka raportuar përqindjet individuale të mëposhtme:

- Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit 21.55% (dhjetor 2023: 20.06%);
- Raporti i kapitalit të nivelit të parë 21.33% (dhjetor 2023: 19.58%);
- Raporti i kapitalit bazë të nivelit të parë 21.33% (dhjetor 2023: 19.58%).